



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura V**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme  
Mbledhja nr. 49  
Prishtinë, më 8 shkurt 2017, në orën 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

**Procesverbal**

**i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme**

**Në mbledhje morën pjesë:** ElmiReçica, Qerim Bajrami, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

**Munguan:** Teuta Rugova e Puhie Demaku.

**Pjesëmarrës nga Ministria e Dialogut:** Edita Tahiri, ministre për dialog, Elona Cecelia dhe Arjeta Rexhaj, këshilltare politike.

**Nga zyra e Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Blerta Bejtullahu – EUSR/EU Oficce, Gazmend Gjyshinca-GLPS, Eugen Cakolli, Artan Murati, Jeta Krasniqi-KDI, Argjend Zejnaj-AAK, Gurjet Zeka, LVV, praktikantë dhe media.

**Mbledhjen e kryesoi:** ElmiReçica, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës:**

**1. Raportim i ministres për Dialog, znj. Edita Tahiri**

**ElmiReçica:** Ministren për Dialog znj. Edita Tahiri e falënderoi për gatishmërinë që ka treguar për t'ju përgjigjur ftesës së Komisionit për të raportuar. Ai theksoi se në këtë takim ministrja është ftuar që të raportojë lidhur me thellimin e bashkëpunimit në mes të vendeve të Ballkanit drejt integritit në organizata ndërkombëtare/tejkalimin e barrierave politike në rajon, temë e cila është paraparë në kuadër të ftesave, që i janë bërë ministrave për të raportuar në Komision, lidhur me organizimin e Samitit të kryetarëve të komisioneve për punë të jashtme, i cili do të organizohet nga data 19 deri më 22 shkurt 2017, në Prishtinë.

Z. Reçica në këtë drejtim kërkoi nga ministrja Tahiri që të informojë lidhur me mundësinë e avancimit të bashkëpunimit me vendet e rajonit drejt integritit në mekanizma ndërkombëtar, kontributin në këtë drejtim për sfidat dhe se, cilët do të ishin hapat që do duhej të ndërmerreshin, në tejkalimin e këtyre sfidave.

**Edita Tahiri** tha se ka kënaqësi, që së bashku me Komisionin të bisedojë lidhur me zhvillimet e Kosovës dhe perspektivën e saj në kuadër të temës së bashkëpunimit rajonal dhe perspektivës euro-atlantike të shtetit tonë. Ajo mëtej theksoi se është obligim i yni kushtetues për të avancuar rrugën e Kosovës drejt integritimit evropian, në NATO, OKB e të gjitha institucionet ndërkombëtare. Sa i përket Kosovës dhe partneritetit të saj rajonal, tha se Kosova ka qenë e para që ia ka hapur rrugën vetes në çështjet ndërkombëtare dhe rajonale, nga fakti se shquhet promotor i paqes, i stabilitetit, i fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimeve rajonale. Si shteti i ri tha se kemi vendosur themelet e një shteti demokratik, me orientim të qartë pro-perëndimor dhe me një vizion euro-atlantik, ku në qendër të politikës së jashtme të Kosovës është aleanca strategjike me SHBA-të, BE-në e vendet e tjera të BE-së dhe të gjitha vendet që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, por edhe bashkëpunimi me ata që nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. Vizioni euro-atlantik i Kosovës është një proces, i cili pos tjerash tha se nënkupton që vlerat euro-atlantike të zbatohen në praktikën e brendshme të vendit tonë, që ne po i bëjmë përmes reformave evropiane dhe euro-atlantike, për të cilat kemi marrë miratimet e duhura tha ministrja.

Qasjen paqësore që e ka Kosova si politikë shtetërore, që 6 vjetë dialogun e Brukselit, një prej detyrave ka pasur edhe heqjen e barrierave që Kosova i ka pasur në rrugën e anëtarësimit në organizata rajonale e më gjerë. Që nga arritja e marrëveshjes për bashkëpunim e përfaqësime rajonale, Kosova është anëtare e gjithë organizatave rajonale të rëndësishme, janë hequr pengesat të cilat Serbia ia bënte Kosovës, ndonëse aty-këtu mund të hasim në ndonjë pengesë, tha ajo. Kosova është bërë anëtare e organizatës së Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, Iniciativës për Bashkëpunim të Evropës Juglindore, anëtare e barabartë e Procesit të Berlinit, e Organizatës për Emigracion dhe Siguri, e RESPA-së dhe shumë organizatave të tjera përtej rajonit. Kosova është anëtare e Konventës së Vulës Apostile, Gjykatës së Arbitrazhit, dhe në fushën e sportit anëtare e Komitetit Olimpik Botëror. Dialogu i Brukselit, po ashtu ka kontribuar drejtpërdrejtë në avancimin e Kosovës në integritet evropian dhe Kosova ka nënshkruar MSA-në me BE-në theksoi Ministrja Tahiri. Së shpejti synohet të kemi partneritetin për paqe të arritur me NATO-në dhe avancimet për integritet në NATO. Synimi tjetër i Kosovës tha se është të anëtarësohemi në OKB, në këtë drejtim duhet të punojmë që të sigurojmë të gjitha njohjet që kanë mbetur për Kosovën dhe në veçanti nga 5 vendet e BE-së. Njoftoi se shteti i Kosovës ka krijuar një bazë të mirë të subjektivitetit ndërkombëtar, sepse pjesa më e fuqishme e botës e ka njohur atë, dhe së fundi me marrjen e kodin telefonik, shtetit i është dhënë edhe një simbol i shtetësisë, si rezultat i marrëveshjes së Brukselit. Kosova në këtë periudhë, përkundër dialogut për fqinjësi të mirë, u ballafaqua me një periudhë të provokimeve destabilizuese nga Serbia që shfaqen një agresion të hapur, por që ne arritëm të mbrojmë sovranitetin e shtetit, theksoi ministrja. Fletë arrestindaj z. Ramush Haradinaj ishte një provokim shumë i rëndë i Serbisë, krahas trenit nacionalist, e murit që ishte ilegal dhe gjuajtjes së bombave me rastin inaugurimit të ndërtesës së qeverisë në veri, tha ministrja Tahiri. Lidhur me zbatimin e marrëveshjeve tha se në këtë fazë kanë mbetur edhe 3 marrëveshje të pazbatuara, marrëveshja për drejtësinë, për energjinë dhe ajo për asociacionin. Bëri të ditur se mbeten të përkushtuar për zbatimin e këtyre 3 marrëveshjeve, dhe më pas dialogu të hyjë në fazën përfundimtare, ku temat e dialogut do të jenë njohja reciproke në mes të dy shteteve, demarkacioni, tema e suksesionit, çështja e të pagjeturve dhe pasojat e tjera të luftës që Serbia duhet t'i kompensojë. Asociacioni tha se është përkushtimi ynë, dhe ky proces do të shoqërohet me shuarjen e të gjitha strukturave të mbetura në Kosovë, sepse Serbia ende ka vazhduar, përkundër marrëveshjeve, t'i mbajë disa struktura.

Znj. Tahiri shpreson se në Samitin i cili do të organizohet nga Komisioni për Punë të Jashtme, Kosova do të prezantohet me një subjektivitet të shtetit, që po përparon fuqishëm dhe sigurt.

**Ismet Beqiri** tha se këto takime dhe raportime tregojnë nivelin e përgjegjësisë tonë, në këtë rast të ekzekutivit ndaj legjislativit për informim të drejtpërdrejtë në mënyrë që të jemi në dijeni për zhvillimet dhe për ato të njoftohen edhe qytetarët tanë. Në këta dy muajt e fundit tha se kemi pasur situata të rënda, për të cilat është dashur të tregohet përgjegjësia e institucioneve dhe qeverisë, gjë që edhe treguan se, si shtet po sillemi ashtu si do duhej të sillemi. Lidhur me ndalimin e z. Haradinajt tha se ai është duke u mbajtur në mënyrë të padrejtë dhe se është personalitet i cili e ka dëshmuar pafajësinë e tij. Z. Beqiri përgëzoi institucionet tona për dinamikën e përgjegjësisë që kanë, duke shtuar se me veprimet e tyre nuk do të dëmtojnë interesat e vendit dhe synimet për integritet evropian.

**Zafir Berisha** lidhur me raportimin e ministres Tahiri tha se ajo në këtë raportim kaloi në temën për dialogun, por sido që është, preku edhe temat me interes për vendin, për të cilat tha se nuk pajtohem të gjithë dhe kemi qëndrime nga këndvështrimet tona. Ai tha se ministrja Tahiri vazhdon bisedimet me një shtet që ka bërë gjenocid në Kosovë dhe këto bisedime janë në disfavor të perspektives dhe zhvillimit të shtetit tonë, gjë që tregojnë edhe tani zhvillimet e fundit. Z. Berisha tha se sovraniteti i shtetit përcenohet vazhdimisht edhe meçështjen e trenit, me hedhjen e bombave në objektin e qeverisë së Kosovës në atë pjesë, ndërsa sa i përket shuarjes së strukturave paralele ministrja Tahiri në një moment tha se janë shuar ato e në momentin tjetër tha se nuk janë shuar të gjitha. Duke u ndërlidhur me përfaqësimin rajonal tha se nuk jemi pajtuar me pikën e marrëveshjes që Kosovën e vë në fusnotë, e që është rezultat i bisedave të udhëhequra nga z. Tahiri dhe me rastin e shqyrtimit të P/ligjit për themelimin e Fondit për Ballkanin Perëndimor, nuk do të miratohet kjo marrëveshje. Z. Berisha pyeti ministren se a e kanë trajtuar në ndonjë forum, se 518 vetë financohen në emër të OJQ-ve nga Rusia, se Rusia ka depërtuar edhe në atë pjesë të vendit dhe se a janë ndërhyrje në sovranitetin e Kosovës, këto veprime të Serbisë?

**Elmi Reçica** theksoi se sot temë diskutimi kemi organizimet rajonale, që është temë e Samitit dhe është ftuar ministrja Tahiri, ndërsa temën e propozuar nga z. Pal Lekaj do ta kemi më pas me ministrin Hoxhaj, për raportet Kosovë- Serbi.

**Qerim Bajrami** fillimisht tha se ministrja Tahiri nuk e ka pozicionin e lehtë të punës, ka një punë specifike, por nga komuniteti boshnjak e ka mbështetjen për dialog. Provokimet e bëra nga Serbia ndaj Kosovës nuk kanë qenë të lehta dhe nuk janë të dobishme për askënd në Ballkan.

Z. Bajrami shtroi çështjen e 80- të të punësuarve në zyrën në veri, e cila u sulmua me bombë, në përbërjen e të cilëve tha se nuk është asnjëri nga komuniteti boshnjak. Ai tha se kemi pasur shumë vërejtje në këtë drejtim dhe nuk e di se në bazë të cilave kritere pranohen ata zyrtarë, që i bie se boshnjakët duhet të jenë aty vetëm kur ka nevojë t'i jepet mbështetja palës shqiptare në cilindo propozim nëpër komuna, ndërsa nuk mund të punësohen, gjë që është e papranueshme sepse komuniteti boshnjak atje është autokton. Mes të tjerash ai njoftoi se asbaskëshortja e të ndjerit Shefko Savkoviç nuk mund të gjejë asnjë vend pune në Komunën e Leposaviqit. Propozoi që në dialog me Serbinë të iniciohet edhe çështja e pensioneve sepse Serbia është obliguar të kthejë fondin pensional në Kosovë, çështje e cila do të duhej të ishte shqyrtuar ndër të parat, e jo të mbetet temë e fundit për shqyrtim në dialog.

**Blerta Kodra Deliu**, lidhur me ngjarjet në pjesën e veriut të vendit tha se ka qenë një vendosmëri e institucioneve të vendit, që duhet të përshëndetet, për të ruajtur sovranitetin e vendit. Ajo tha se ka disa pyetje të cilat e kalojnë domenin e Samitit dhe pyeti ministren Tahiri se: psemarrëveshja për drejtësi

nuk ka filluar të zbatohet, më 10 janar, ashtu siç ka qenë e paraparë, ku janë ngecjet në këtë proces dhe pse kjo marrëveshje nuk është e publikuar në ueb- faqen e qeverisë; kur pritet të themelohet asociacioni i komunave me shumicë serbe, cilat janë hapat të cilët do të ndërmerren në këtë drejtim; a është themeluar grupi punues për vlerësimin mbi shuarjen e strukturave paralele në veri të vendit, kush do të jetë në përbërje të këtij grupi punues, çfarë masash do të ndërmerren për të mos lejuar vakum institucional në veri të vendit; cili është plani i ri për urën e Mitrovicës dhe për çfarë bëhet fjalë lidhur me atë se do të ketë një pengesë që garanton sigurinë e qytetarëve dhe cili do të jetë roli i ministres Tahiri, në fazën e re të dialogut?

Duke u ndërlidhur me Ligjin për ratifikimin e marrëveshjes për Fondin e Ballkanit Perëndimor që pritet të miratohet në seancë, pyeti se a do të ketë mundësi që Kosova gjatë kësaj faze së re të mos ketë fusnotën dhe se çfarë po bëhet në ngritjen si shqetësim të çështjes së fshehjes së raportit për krimet e luftës në Kosovë, sipas raportit për të drejtën humanitare.

**Pal Lekaj** tha se ka pritur nga ministrja se do ta sjellë një raport me shkrim lidhur me temën e cila do të diskutohet. Theksoi se ne jemi të anëtarësuar në disa organizata, por jo që ndikojnë ato tepër në forcimin e shtetit apo se janë dobi prurëse për Kosovën dhe se kanë peshë në forcimin e shtetit të Kosovës. Përderisa ministrja tha se është forcuar shteti i Kosovës, është për të ardhur keq që shtetit të Kosovës po i ndalohen qytetarët në këtë rast ndalohet Z. Haradinaj në Francë me fletë arrest të Serbisë që është ndërhyrje brenda shtetit të Kosovës, që është e patolerueshme, tha ai. Z. Lekaj tha se ende ekzistojnë strukturat paralele, se pesë vendet e BE-së, ende janë larg njohjes së vendit tonë dhe përmes dialogut fusnota është shndërruar në flluskë që me shumë vështirësi do të mund të largohet. Nënshkrimi për përdorimin e fusnotës është në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës e cila e njeh Kosovën si shtet të pavarur dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.

Z. Lekaj tha se nuk është zbatuar Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për rrëzimin e murit, është bërë një memorandum mirëkuptimi mes Rakiqit dhe nuk është përmendur fare Rezoluta e Kuvendit që ka qenë obligim. Jemi larg shtrirjes së sovranitetit në këtë pjesë të vendit që është jetike për Kosovën. Ai shtoi se edhe për ndërrimin e formatit të dialogut që është bërë në mënyrë të ngutshme pa u ndërprerë një dialog i filluar, pa i analizuar të gjitha marrëveshjet, nuk kemi ndonjë informatë.

**Luljeta Veselaj-Gutaj** tha se ne të gjithë e dimë që integrimi i evropian është objektiv i parë dhe strategjik i vendit, është një alternativë e madhe për zhvillimin e vendit duke u fokusuar edhe në zhvillimin ekonomik. Destabilizimi i Kosovës ende po mbetet qëllim i përhershëm i Serbisë dhe zhvillimet e fundit që kanë ndodhur kohëve të fundit, kanë qenë preokupim i të gjithë qytetarëve të Kosovës. Marrëveshjet e arritura përmes dialogut, shumë pak nga ato ne i kemi pa para se të nënshkruhen dhe nuk kemi pasur mundësi të reagojmë, tha ajo. Kërkoj ngakryenegociatorja që të paktën komisioneve përkatëse t'u sillen marrëveshjet paraprakisht që të analizohen e diskutohen, para se të nënshkruhen në Bruksel. Duke cekur se në vazhdimisht jemi penguar për anëtarësim në organizata ndërkombëtare, pyeti ministren Tahiri se, a është diskutuar konkretisht lidhur me pengimin për anëtarësim në UNESCO dhe se a është diskutuar lidhur me Raportin për të drejtën humanitare, dhe çka pritet në të ardhmen lidhur me të.

**Edita Tahiri** lidhur me fletë-arrestin arbitrar që Serbia e ka bërë dhe si pasojë e tij lideri i AAK-së Z. Haradinaj është ende në Francë duke u mbrojtur në liri. Qeveria dhe të gjitha institucionet tona maksimalisht janë angazhuar, veçmas MPJ dhe MD-së, për të kontaktuar me faktorin ndërkombëtar e autoritet franceze që ky proces të përfundojë, që është abuzim i legjislacionit të krimeve të luftës nga Serbia, pas përfundimit të mandatit të Hagës. Ministria e Drejtësisë ka bërë shpjegimet e duhura pranë faktorit ndërkombëtar se Serbia nuk mundet të trashëgojë juridiksionin e krimeve të luftës përtej juridiksionit të vet sepse Kosova është shtet i pavarur i njohur nga 113 shtete dhe është anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare, si Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar e shumë

organizatave të tjera. Krahas përkrahjes institucionale për lirimin sa më të shpejtë të z. Haradinajt ne do të zhvillojmë betejën diplomatike për ta ndalur Serbinë, që të dalë jashtë juridiksionit të saj, tha ministrja. Dialogu në Bruksel është i vështirë, por duhet të zhvillohet sepse pas luftës vjen paqja dhe të gjithahistoritë e shteteve që kanë bërë luftëra pastaj kanë dialoguar dhe kanë bërë paqen. Bëri të ditur se edhe më parë kemi biseduar me Serbinë, në Rambuje kemi biseduar edhe në Vjenë për dy vjet dhe më pas u shpall pavarësia e Kosovës. Në Bruksel po bisedojmë sepse nga viti 1999, që kur UNMIK-u e mori administrimin ndërkombëtarë të Kosovës, në veri Serbia e ktheu ndikimin me struktura paralele dhe sovraniteti i Kosovës në veri ka qenë i cenuar vazhdimisht. Tani këto gjashtë vjet të dialogut ne po shtrimë sovranitetin në fushat ku janë arritur marrëveshjet, kemi vendos policinë e Kosovës në veri, organet e kontrollit doganor, kemi vendosur regjimin e lëvizjes së lirë, qytetarët e Serbisë nuk hynë më në Kosovë të pa legjitimuar dhe qytetarët e Kosovës udhëtojnë në Serbi me dokumente të Republikës së Kosovës, njoftoi ajo. Janë shuar doganat paralele, vulat paralele, janë mbyllur zyrat e regjistrimit civil ilegal.

Sot i kemi zyrat e regjistrimit civil të Republikës së Kosovës dhe interesimin e madh të serbëve për të marrë dokumentet e Kosovës. Strukturat paralele në Kosovë janë shuar në fushat ku janë arritur marrëveshjet, por ka ende të arrihet në arsim e shëndetësi. Marrëveshja për drejtësi tha se u vonua sepse tensionet që i krijoi Serbia që nga dhjetori, e kanë vonuar siç kanë vonuar edhe asociacionin.

Pas heqjes së murit në Mitrovicë, ministrja njoftoi se sipas planit nuk do të ketë më mure, por do të jenë vetëm disa elemente zbkuruese të cilat do të jenë në pajtim me ligjet e Kosovës.

Ministrja Tahiri njoftoi se rrugën e dialogut në Bruksel e kanë zgjedhur përtështirë sovranitetin në veri të vendit, sepse UNMIK-u nuk arriti ta administrojë pjesën veriore të vendit.

Se ka ndryshime pozitive në veri të vendit është fakti se pas dialogut në Bruksel katër komunat në veri të vendit morën pjesë në zgjedhjet e vendit. Serbia ka vazhduar të mbajë disa elemente komunale paralele, por kemi vënë kusht se asociacioni nuk themelohet pa i vënë në zero strukturat e mbetura paralele, tha ajo. Sa i përket dialogut, ministrja tha se ai është duke hyrë në fazën përmbyllëse dhe në të ardhmen do të kërkojnë një format me përfaqësim të plotë të shtetit të Kosovës, ashtu siç ishim në Vjenë. Lidhur me çështjen e fusnotës ministrja Tahiri, tha se Kosova ka pasur fusnotë edhe para fusnotës që është bërë në dialogun Brukselit, duke u thirrur pas emrit të Kosovës në Rezolutën 1244. Fusnota është duke e hapur rrugën e Kosovës drejt integriteteve evropiane sepse pesë vendet mos njohëse të BE-së, nuk do ta votonin MSA pa e pasur një mbulesë siç është fusnota, dhe ajo do të hiqet kur këto pesë vende do ta njohin pavarësinë e Kosovës. Sa i përket shqetësimeve të ngritura nga deputeti Bajrami tha se ato janë të bazuara, ndërsa për rastin e zonjës së të ndjerit z. Savković, tha se do të shikojë mundësinë e zgjidhjes së këtij problemi. Ministrja Tahiri njëkohësisht theksoi se anëtarët e Komisionit, janë të mirëseardhur në takim në Bruksel, së bashku me të.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

---

ElmiReçica